



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 12, datë 29.12.2016

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“SHITESË NË PROJEKTIN E RIKUALIFIKIMIT URBAN TË PAZARIT TË RI,
MARKATËS SË MISHIT-FRUTA-PERIMEVE DHE TË SHESHIT AVNI RUSTEMI,
BASHKIA TIRANË”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të Bashkisë Tiranë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Shtesë në projektin e Rikualifikimit Urban të Pazarit të Ri, Markatës së Mishi-Fruta-Perimeve dhe të Sheshit “Avni Rustemi”, Bashkia Tiranë”, me subjekt zhvillues Bashkia Tiranë.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit zhvillues vetëm pas:
 - miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave për pasuritë e shpronësuara.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

E DI RAMA



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

